

RAPORT PERIODIK I MONITORIMIT
QENDRA HISTORIKE E PRIZRENIT, ZONË E (PA)MBROJTUR
Shkurt 2014, Prizren

PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje ekzekutive	2
II. Hyrje	5
III. Sfondi ligjor	5
IV. Zona e (Pa)Mbrojtur	6
V. Të gjeturat e monitorimit	7
VI. Rekomandimet	9
VII. Aktivitetet/raportimi	11
VIII. Ndikimi i projektit	11
IX. Për projektin	12
X. Pse monitorimi i Urbanizmit	12
EC Ma Ndryshe	15

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm", i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Saraqët 5, 20000/Prizren ~ Rr. Perandori Dioklician, Nr. 14, kati(V), 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 038-224-967 & 029-222-771

I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i titulluar “Qendra Historike e Prizrenit, Zonë e (Pa)Mbrojtur” përmban brenda vetes punën gjashtë mujore (gusht 2013- janar 2014) të monitorimit të zhvillimeve në sektorin e Urbanizmit brenda komunës së Prizrenit, në kuadër të projektit “Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”. Kjo analizë përqendrohet në evidentimin e mos respektimit të kriterëve urbanistike në pjesë të ndryshme të qytetit të Prizrenit, me një kujdes të veçantë ndaj Qendrës Historike të Prizrenit, që cilësohet si Zonë e Mbrojtur me Ligj të posaçëm¹, me ç’rast gjatë periudhës raportuese janë evidentuar një morri shkeljesh ligjore që dëmtojnë vlerat e trashëgimisë kulturore brenda kësaj hapësire.

Sipas një kuptimi të përgjithshëm urbanizmi mund të përkufizohet si ndërveprim i forcave sociale, politike, kulturore dhe ekonomike që ndikojnë në formësimin e qyteteve. Të gjitha këto forca duhet të kontribuojnë dhe marrin pjesë në krijimin e një jetese më të mirë urbane. Mirëpo ky kuptim nuk po gjen zbatim ende në Prizren e aq më pak në Qendrën Historike të tij.

Analisti Fatos Lubonja duke folur për degradimin urbanistik në Tiranë, veçon njerëzit që nuk dinë të harmonizojnë interesin e ngushtë personal me atë të shoqërisë, të cilët nuk dinë të kuptojnë, se “historia që përmban arkitektura e një qyteti, gjelbërimi i tij, hapësirat publike dhe peizazhi i tij urban rrit atë që quhet “cilësi e jetës” së tyre”². Sipas tij po të kishte ekzistuar një kulturë tjetër shoqërore, horrorret që janë bërë nuk do të kishin ndodhur.

Mentaliteti i ngjashëm në periudhën e pasluftës është përhapur edhe në Prizren, ku përgjatë viteve aprovimi i ligjeve dhe krijimi i mekanizmave të reja, nuk kanë sjellë ndonjë efikasitet në ruajtjen e zonave urbane dhe atyre të mbrojtura nga shkatërrimi, që ka ardhur si pasojë e veprimeve për realizimin e interesave individuale të ‘fuqishmëve’ ose grupeve të caktuara të interesit. Institucionet e niveleve të ndryshme deri më tani nuk kanë dhënë sinjale të përgjegjësive publike për ruajtjen e kësaj zone të pasur me elemente të trashëgimisë kulturore. Në këtë mënyrë “zhvillimi i pakontrolluar është manifestuar me çintegrim urban, planifikim të pa-balancuar hapësinor, humbjen e tokës bujqësore, e deri te degradimi i trashëgimisë natyrore në zonat rurale, derisa mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara të interesit, qoftë nga biznesi apo politika, në kurriz të ambientit jetësor të qytetarëve ka bërë që qyteti dhe zonat e mbrojtura të përfshihen nga një kaos urbanistik shkatërrimtar, pasojat e të cilit do të jenë afatgjate”³.

Ky trend i degradimit urbanistik, madje mu në zemrën e qytetit (lexo: Qendrën Historike) nuk është ndaluar nga autoritetet shtetërore të niveleve të ndryshme, ndërkohë që as presioni ndërkombëtar nuk ka prodhuar ndonjë rezultat konkret, pos që ka krijuar shumë-shtresim të ligjeve dhe mekanizmave ruajtës, që përfundimisht po tregohen të padobishme, ngase këto dispozita dhe trupa të krijuara pa konsultime me popullatën, nuk po respektohen as nga vet autoritetet respektivisht Komuna e Prizrenit.

¹ Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

² Fatos Lubonja, Intervistë Gazeta Shqip, <http://gazeta-shqip.com/lajme/2012/09/21/plani-urbanistik-i-tiranes/>, qasur më 11.1.2014

³ Marrë nga analiza “Degradimi natyror dhe urbanistik”, http://www.online-transparency.org/repository/docs/EC_Degradimi_na_tyror_dhe_urbanistik_final_analiza.pdf

Gjatë monitorimit gjashtë mujor EC Ma Ndryshe ka evidentuar raste të mospërfilljes së plotë të ligjeve nga ana e Komunës së Prizrenit.

Për ilustrim të këtij konstatimi duhet sqaruar se projekti gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar çështjen e renovimit të oazës dhe trotuarit në mes të urës së Arastës dhe urës së Gurit, me ç'rast ka gjetur se punimet ndërtimore në projektin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të komunës së Prizrenit kanë nisur pa respektimin e procedurave ligjore respektivisht marrjen e pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Historike të Prizrenit dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturor.

Monitoruesit po ashtu kanë vërtetuar se intervenimet respektivisht ndriçimi i Urës së Gurit dhe riparimi dhe ndriçimi i Urës së Arastës janë bërë pa lejen e DUPH-së dhe pa pëlqimin e IMMH-së, që përbën shkelje të drejtpërdrejta të dispozitave të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit. EC Ma Ndryshe ka gjetur se institucionet e nivelit lokal dhe ato qendrore nuk i kanë përmbushur obligimet administrative e financiare që kanë ndaj Qendrës Historike të Prizrenit të përshkruara në Ligjin përkatës, që ka hyrë në fuqi para afër një viti e gjysmë. Për më shumë institucionet nuk i janë përmbajtur as premtimeve e zotimeve të prezantuara para opinionit publik në periudhën para miratimit të ligjit.

Gjithashtu është analizuar çështja e ndërtimit të një shtëpie individuale të banimit pranë Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku institucionet kanë dhënë leje ndërtimore përkundër shqetësimeve dhe vërejtjeve të ngritura nga përgjegjësit e këtij kompleksi, për ngufatjen e hapësirës përreth monumentit më të vizituar historik në Kosovë.

Këto raste janë edhe një dëshmi se Qendra Historike e Prizrenit është Zonë e Pa Mbrojtur. Përpjekja e institucioneve kinse për ta mbrojtur këtë Zonë me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit po tregohet e dështuar një vjet e gjysmë pas hyrjes në fuqi të ligjit përkatës. Dëshmia tjetër banale për këtë është mos caktimi i inspektorëve respektivisht mos zbatimi i deritanishëm i nenit 19 të Ligjit që thotë se "organi komunal për inspektim në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit, cakton inspektorë për mbikëqyrjen e aktiviteteve dhe zhvillimeve në Qendrën Historike të Prizrenit"⁴.

Duke e marrë parasysh situatën ekzistuese në Qendrën Historike të Prizrenit, ku ekzistimi i ligjeve paraprake, pastaj miratimi i Planit të Konservimit dhe së fundi aprovimi i Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, nuk kanë prodhuar rezultate të duhura në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, EC Ma Ndryshe propozon që në këtë Zonë të Mbrojtur të involvohen edhe autoritetet qendrore, pra MMPH-ja, MKRS-ja dhe MAPL-ja me qëllim që të sigurojnë zbatimin e ligjeve në fuqi dhe të ndalojnë degradimin e mëtejshëm urbanistik.

Patricia Rodríguez Alomá në artikullin e saj⁵ mbi rehabilitimin dhe zhvillimin e integruar të qendrave historike thekson se vullneti politik dhe vendimmarrja në nivelet më të larta janë esenciale për ruajtjen dhe zhvillimin e qendrave historike.

Menaxhimi i integruar i kësaj Zone mbetet zgjidhja më e mirë. Apo siç propozon Dr. Nan Ellin në librin e saj "Urbanizmi i Integruar", "Në vend që t'i lëmë pasdore, braktisim ose ta

⁴ Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

⁵ "The Recovery of Historical Centres and their integrated development",

http://hdrnet.org/319/1/br_17_35.pdf

shlyejmë trashëgiminë tonë urbane, Urbanizmi i Integruar mundëson ruajtjen e ndërtesave, lagjeve dhe peizazheve natyrore që i vlerësojmë; rehabiliton, kërkon, rikthen ose rinovon ato që nuk janë në gjendje të mirë dhe shton atë që nuk e kemi ende por e dëshirojmë, në bazë të informatave të marra nga përfshirja efektive e komunitetit”.⁶

Të gjeturat:

- Komuna e Prizrenit pa vullnet politik për ndalimin e degradimit urbanistik në Qendrën Historike;
- Institucionet të pafuqishme për mbrojtjen e objekteve me vlera të Prizrenit;
- Qendra Historike pa mjete të nevojshme financiare;
- Intervenime ilegale në urën e Gurit dhe Arastës;
- PZHKP: Trashëgimia kulturore në Prizren është në degradim e sipër;
- Raporti i Progresit 2013 konfirmon degradimin e trashëgimisë kulturore nga ndërtimet pa leje;
- Ndërtimet pa leje po e dëmtojnë urbanizmin dhe buxhetin komunal;
- Drejtoria e Urbanizimit realizon projektin në mënyrë ‘klandestine’;
- Institucionet ngufasin hapësirën rreth LSHP-së.

Rekomandimet:

- Autoritetet qendrore duhet të përfshihen në mbrojtjen e Qendrës

Historike, duke siguruar zbatimin e ligjeve;

- Institucionet t’i mbrojnë objektet me vlera të Prizrenit;
- Të nis procesi i rishikimit dhe ndryshimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit;
- Të rritet mbikëqyrja inspektuese nw OHPz, në mënyrë që praktikrat e realizimit të projekteve pa lejet përkatëse të institucioneve përgjegjëse të mos përsëriten më;
- PZHKP të shërbej si pikënisje për ndalimin e degradimit urbanistik në Prizren;
- Komuna dhe MMPH e MKRS ta lexojnë drejt Raportin e Progresit 2013 dhe të veprojnë menjëherë;
- Komuna të reflektoj mbi të gjeturat e Auditorit në lidhje me lejet ndërtimore dhe të zbatoj rekomandimet e ZAP-it;
- DUPH të ndërpres praktikën ‘klandestine’ të realizimit të projekteve;
- Trekëndëshi institucional, DUPH, IMMh dhe MKRS të kenë një koordinim më të mirë gjatë shqyrtimit të kërkesave për lejet ndërtimore afër monumenteve të rëndësishme historike.

⁶ Dr. Nan Ellin, ‘Integral Urbanism’, 2006, Rotledge, Taylor & Francis Group

II. Hyrje

Qyteti i Prizrenit është ngritur në hapësirën ku dy kultura dhe tri religjione të mëdha janë takuar gjatë historisë, duke lënë gjurmë e duke ndërtuar objekte, të cilat edhe sot e kësaj dite dëshmojnë para gjeneratave të reja mbi ndodhitë dhe personalitetet e së kaluarës⁷.

Objektet e ndryshme, veçanërisht rreth unazës së qendrës së Prizrenit, paraqesin trashëgimi me vlerë të veçantë historike jo vetëm për qytetin dhe Republikën e Kosovës, por edhe për tërë rajonin e botën. Bashkë me monumentet ekziston edhe një trashëgimi e pasur kulturore, të cilën e kanë ruajtur qytetarët e Prizrenit. Prandaj, si në periudhën e ish-Federatës Jugosllave, atë të administrimit të UNMIK-ut dhe në Kosovën e pavarur janë hartuar ligje e politika të ndryshme për ruajtjen e kësaj zone.

Kuadri ligjor për Qendrën Historike të Prizrenit është mjaft i gjerë, por pa zbatim të duhur në terren. Krahas Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, atë të Planifikimit Hapësinor, etj. vet Komuna e Prizrenit ka investuar në hartimin e Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2008).

Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës historike të Prizrenit përkufizon se Trashëgimia Kulturore e Prizrenit reflekton historinë e mrekullueshme të qytetit me një kulturë të shtresuar gjatë shekujve deri në ditët e sotme⁸.

Në harmoni me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Pakon e

Ahtisaarit), Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Prizrenit e përcakton Prizrenin si trashëgimi urbane që posedon numër të madh të objekteve monumentale dhe popullore nga origjina të ndryshme kulturore që duhet të mbrohen. Pasi që diversiteti funksional, kulturor dhe fetar formon pjesën integrale të jetës urbane në Prizren, fuqimisht inkurajohet koekzistenca paqësore e aktiviteteve të ndryshme mbi një hapësirë urbane të përbashkët⁹.

Mirëpo, qëndrimi në sirtarë i këtij Plani dhe vazhdimi i degradimit në Qendër të Prizrenit ka shtyrë mbikëqyrësit e pavarësisë së Kosovës që të bëjnë presion edhe për hartimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, që ka hyrë në fuqi në korrik të 2012-ës, përkundër kundërshtive të shumta të shoqërisë civile, e cila argumentonte se nuk ka nevojë për ligje të reja dhe shtresim të mëtutjeshëm të mekanizmave. Madje OJQ-të e Prizrenit patën theksuar se me ligjin e ri “injorohet kuadri ekzistues ligjor dhe institucional pasi që Kosova posedon me legjislacion të mjaftueshëm dhe institucione adekuate për mbrojtje të trashëgimisë kulturore”¹⁰.

III. Sfondi ligjor

Shteti i Kosovës ka kornizë legjislative dhe institucionale shumë të favorshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në rastin e Qendrës Historike të Prizrenit, përveç legjislacionit bazik (trashëgimia kulturore dhe

⁷ Prizren360.com, <http://kk.rks.gov.net/prizren/Home.aspx>

⁸ Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës historike të Prizrenit, <http://kk.rks.gov.net/prizren/getattachment/25fdb992-4fa8-4623-9811-ae22a0bd6b2a/Plani-i-Konservimit-dhe-Zhvillimit-te-Zones-Histor.aspx>

⁹ Po aty, faqe 22

¹⁰ Letër deputetëve të Kosovës, nga Koalicioni ad-hoc i OJQ-ve në mbrojtje të Qendrës Historike të Prizrenit, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/10_a_rsyet_pse_duhet_votuar_kunder_ligjit.pdf

planifikimi hapësinor) janë miratuar edhe ligjet për zonat e veçanta të mbrojtura dhe ai për Qendrën Historike të Prizrenit. Në të njëjtën kohë, Kuvendi i Komunës së Prizrenit ka të miratuar edhe master planin për konservimin dhe zhvillimin e kësaj zone.

Qendra Historike mbrohet me një ligj të veçantë, qëllimi i të cilit është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohorë të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar. Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit kërkon nga Komuna e Prizrenit, që në konsultim me Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit të hartojë, miratojë dhe zbatojë dokumentet e planifikimit hapësinor dhe urbanistik që kanë të bëjnë me Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Trashëgiminë kulturore.

Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit i ka paraprirë Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, që precizonte se Zona e Veçantë e Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të themelohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM dhe do të përfshijë objektet e Kishës Ortodokse, objektet otomane, katolike, laike dhe objektet e tjera të rëndësishme të veçantë historike dhe kulturore.

Në anën tjetër, Kuvendi i Komunës së Prizrenit në vitin 2008 pati miratuar Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit. Ky dokument përcakton parametrat e mbrojtjes dhe zhvillimit të qendrës historike, si dhe përfshin analiza të zonës lidhur me transportin në zonën e planifikuar, shfrytëzimin e tokës dhe

shfrytëzimin e ndërtesave në katin përdhësë dhe katin e parë, gjendjen e ndërtesave, etazhitetin e ndërtesave, materialet ndërtimore, pronat, zotërimin e ndërtesave, përshtatshmërinë e ndërtesave me strukturën fizike të zonës dhe rrethinës së saj.

IV. Zona e (Pa)Mbrojtur

Aprovimi i ligjeve dhe krijimi i mekanizmave të reja, nuk kanë sjellë ndonjë efikasitet në ruajtjen e zonës së mbrojtur për shkak se interesat individuale të 'fuqishmëve' dhe të grupeve të caktuara të interesit kanë mbizotëruar tek niveli politik i institucioneve në krahasim me nevojën për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Mos zbatimi i përpiktë i Planit të Konservimit dhe ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës kanë bërë që në Qendrën Historike të merr hov aktiviteti i egër ndërtimor, pa respektim të kriterëve të përcaktuara urbanistike, duke sulmuar dhe dëmtuar në mënyrë të pamëshirshme vlerat e trashëgimisë kulturore. Përgjatë kësaj periudhe Prizreni është shndërruar në model të shpjegimit se si nuk duhet realizuar zhvillimin urban. Shqetësimet që shoqëria civile e qytetit i pat ngritur prej vitesh në lidhje me transformimin e strukturës urbane të qytetit dhe shkatërrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore prej interesave të ngushta të grupeve të biznesit dhe politikës, së fundmi kanë zënë vend edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian.

Ky Raport në mënyrë eksplicite konstaton se "interesat biznesore shpesh herë mbizotërojnë kundruall interesave të trashëgimisë

kulturore”¹¹, duke aluduar në ndërtimet pa leje. Njëherësh, Komisioni Evropian, në pjesën e raportit që flet për të drejtat kulturore ka bërë thirrje për “veprime të fuqishme për të ndaluar aktivitetet ilegale dhe degraduese si dhe korrigjimin e atyre ndërtimeve që kanë tejkalime”¹².

Mirëpo monitorimi i EC Ma Ndryshe ka gjetur se edhe vet organet komunale nuk kanë treguar vullnet të mjaftueshëm për të zbatuar ligjin, por as politikat e veta publike në këtë zonë të veçantë, duke i mbyllur sytë para dëmtimit të vlerave të qytetit e në rastet konkrete duke u bërë edhe vetë shkelës të dispozitave ligjore e procedurave që duhet të ndiqen gjatë realizimit të projekteve me fonde publike në Qendrën Historike të Prizrenit. Madje institucionet e nivelit lokal kanë dështuar që të zbatojnë një vendim të KK-së së Prizrenit që thjeshtë ndalon lëvizjen e të gjitha automjeteve gjatë fundjavës brenda zonës historike.

Ky trend i degradimit urbanistik, nuk është ndaluar as nga autoritetet shtetërore të niveleve të ndryshme, ndërkohë që as presioni ndërkombëtar nuk ka prodhuar ndonjë rezultat konkret, pos që ka krijuar shumë-shtresim të ligjeve dhe mekanizmave ruajtës, që përfundimisht po tregohen të padobishme, ngase këto dispozita dhe trupa nuk po respektohen nga Komuna e Prizrenit. E tërë kjo situatë e krijuar shpie drejt konstatimit se Qendra Historike e Prizrenit është Zonë e Pa Mbrojtur. Përpjekja e institucioneve kinse për ta mbrojtur këtë Zonë me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit po tregohet e dështuar një vjet e gjysmë pas hyrjes në fuqi të ligjit

përkatës. Pra, pa vullnetin e duhur politik dhe përfshirjen e niveleve më të larta të vendimmarrjes vështirë se mund të bëhet fjalë për ruajtjen dhe zhvillimin e kësaj qendre historike, që më nuk e meriton një epitet të tillë për shkak të transformimit të egër që ka pësuar.

V. Të gjeturat e monitorimit

Gjatë periudhës raportuese monitoruesit e sektorit të urbanizmit kanë hulumtuar disa raste, me ç’rast janë konstatuar shkelje të ndryshme procedurale e ligjore.

Të gjeturat e monitorimit gjatë gjashtë muajve të kaluar janë:

Komuna nuk po tregon vullnet politik për ndalimin e degradimit urbanistik në Qendrën Historike – EC Ma Ndryshe gjatë vitit të kaluar (maj 2013) pat kërkuar nga DI-ja listën e objekteve apo ndërtimeve pa leje që duhen ekzekutuar (rrënuar) brenda territorit të komunës së Prizrenit dhe përgjigja e DI-së ishte se “presim që në radhë të parë të aprovohet në terren Ligji për Legalizimin e objekteve dhe ato objekte të cilët nuk i plotësojnë kriteret e Ligjit për Legalizim do të rrënohen”. Meqë Ligji për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje nuk parasheh legalizime të objekteve pa leje brenda Zonave të Mbrojtura, rrjedhimisht DI-ja duhet të ndërmerr veprime konkrete ndaj ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit. EC Ma Ndryshe më 9 janar ka parashtruar kërkesën për informim në lidhje me masat që do të ndërmerr DI-ja dhe deri më 17 janar nuk ka marrë asnjë përgjigje nga kjo drejtori, e cila në këtë mënyrë ka shkelur dispozitat e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, duke treguar kështu papërgjegjësi institucionale dhe mungesë të llogaridhënies.

¹¹Raporti i Progresit, 2013, Komisioni Evropian, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/ks_rapport_2013.pdf

¹²Po aty

Institucionet të pafuqishme për mbrojtjen e objekteve me vlera të Prizrenit – Hetimet në lidhje me djegien e shtëpisë së familjes Shehu në lagjen “Tabakhanë” nxjerrin në pah faktin se zjarri në këtë objekt ishte shkaktuar nga instalimi i vjetër i rrymës elektrike. Humbja e kësaj vlere kulturore të qytetit është edhe një tregues se institucionet përgjegjëse po tregohen të pafuqishme për parandalimin e rasteve të tilla, veçanërisht në Qendrën Historike të Prizrenit.

Qendra Historike pa mjete të nevojshme financiare – Institucionet e nivelit lokal dhe ato qendrore nuk i kanë përmbushur obligimet buxhetore që kanë ndaj Qendrës Historike të Prizrenit të përshkruara në Ligjin përkatës, që ka hyrë në fuqi para afër një viti e gjysmë. Për më shumë institucionet nuk i janë përmbajtur as premtimeve e zotimeve të prezantuara para opinionit publik në periudhën para miratimit të ligjit.

Intervenime ilegale në urën e Gurit dhe Arastës – DSHP me 11 shtator 2013 ka lëshuar pëlqimin për NSH “Hisar Kosova” për pastrimin e shtratit të Lumëbardhit, rregullimin e mureve mbrojtëse në vendet e dëmtuara dhe ndriçimin e Urës së Arastës dhe Urës së Gurit. Në bazë të informatës së pranuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor intervenimet në këto dy ura janë bërë pa lejen paraprake të këtij dikasteri. As IMMH-ja nuk ka dhënë pëlqim. Pra, ndriçimi i Urës së Gurit dhe riparimi dhe ndriçimi i Urës së Arastës janë bërë pa lejen e DUPH-së dhe pa pëlqimin e IMMH-së, që përbën shkelje të drejtpërdrejta të dispozitave të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

PZHKP: Trashëgimia kulturore në Prizren është në degradim e sipër – PZHKP është miratuar nga Kuvendi i Komunës më 17 shtator 2013. Në këtë

dokument bëhet e ditur se trashëgimia kulturore në Prizren është në degradim e sipër. “Mungesa e përpjekjeve për konservim, ndërtimet e reja përkundër planeve konservuese dhe stoku i pashfrytëzuar i ndërtimit rezultojnë në probleme të mëdha fizike”, thuhet në këtë dokument, ku sqarohet se Plani për Konservimin e Zonës Historike të Prizrenit është një aset fundamental për ruajtjen e qëndrueshmërisë së trashëgimisë kulturore, që megjithatë nuk ka gjetur zbatim as disa vite pas miratimit. Zhvillimet që kundërshtojnë planin e konservimit mund të vërehen qartë në qendrën historike të qytetit që rezulton me degradimin e karakterit historik”, thekson PZHKP. Edhe në pjesën ku flitet për zhvillimin e turizmit PZHKP konstaton se trashëgimia kulturore, sidomos në Prizren, është duke u shkatërruar si rezultat i mungesës së përpjekjeve konservuese, si dhe ndërtimeve të reja në kundërshtim me planet për konservim.

Raporti i Progresit 2013 konfirmon degradimin e trashëgimisë kulturore nga ndërtimet pa leje – Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2013 ka konfirmuar shqetësimet e shoqërisë civile në Prizren dhe Kosovë për degradimin e trashëgimisë kulturore. Raporti në mënyrë eksplicite konstaton se “interesat biznesore shpesh herë mbizotërojnë kundruall interesave të trashëgimisë kulturore”, duke aluduar në ndërtimet pa leje. Njëherësh, Komisioni Evropian, në pjesën e raportit që flet për të drejtat kulturore ka bërë thirrje për “veprime të fuqishme për të ndaluar aktivitetet ilegale dhe degraduese si dhe korrigjimin e atyre ndërtimeve që kanë tejkalime”.

Ndërtimet pa leje po e dëmtojnë urbanizmin dhe buxhetin komunal – Zyra e Auditorit të

Përgjithshëm ka identifikuar si mangësi të Komunës së Prizrenit, mos sigurimin e një bazë të plotë të të dhënave për numrin e kërkesave për leje, lejet e lëshuara, dhe refuzimet për vitin 2012; dhe në tri raste ka konstatuar se komuna kishte lëshuar vendim për ndërtimin e dy kateve, ndërsa inspektorët në terren kanë vërejtur tejkalime në ndërtimin e objekteve dhe janë ndërtuar më shumë kate se sa është përcaktuar me leje ndërtimi. “Mungesa e një baze të plotë të të dhënave për lejet e ndërtimit, si dhe tejkalimi i kateve të lejuara të ndërtimit, rritë rrezikun që tarifat të mos kalkuloohen saktë dhe të kemi një nënpagesë të të hyrave”, është rreziku i identifikuar në Raportin e Auditimit.

Drejtoria e Urbanizimit realizon projektin në mënyrë ‘klandestine’ – Gjatë shqyrtimit të çështjes së renovimit të oazës dhe trotuarit në mes të urës së Arastës dhe urës së Gurit është gjetur se punimet ndërtimore në projektin e Drejtorisë së Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të komunës së Prizrenit kanë nisur pa respektimin e procedurave ligjore respektivisht marrjen e pëlqimit nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve Historike të Prizrenit dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturorë.

Institucionet ngufasin hapësirën rreth LSHP-së – Gjatë analizës së procesit të ndërtimit të një shtëpie individuale të banimit pranë Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përkundër shqetësimeve dhe vërejtjeve të ngritura nga përgjegjësit e këtij kompleksi, për ngufatjen e hapësirës përreth këtij monumenti është gjetur se nuk ka pas asnjë nismë për kompensimin e pronarit të shtëpisë afër LSHP-së dhe hapjen e hapësirës rreth kompleksit më të vizituar historik të Kosovës.

VI. Rekomandimet

Në bazë të këtyre të gjeturave EC Ma Ndryshe ka rekomanduar ndërmarrjen e një numri veprimesh për të përmirësuar gjendjen në urbanizmin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të qytetit.

- *Autoritetet qendrore të përfshihen në mbrojtjen e Qendrës Historike*

Në këtë Zonë të Mbrojtur duhet të involvohen autoritetet qendrore, pra MMPH-ja, MKRS-ja dhe MAPL-ja me qëllim që të sigurojnë zbatimin e ligjeve në fuqi dhe të ndalojnë degradimin e mëtejshëm urbanistik. MMPH, ashtu siç ka pezulluar autoritetin e organeve të Komunës së Prizrenit në Prevallë për shkak të mungesës së vullnetit për veprim e lejimit të degradimit urbanistik dhe shkeljes së ligjeve, të njëjtën praktikë mund ta përdor edhe në Qendrën Historike të Prizrenit, në koordinim me MKRS-në, që ka përgjegjësi sa i përket ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Me këtë veprim, MMPH do të jepte edhe dëshminë se rasti “Prevala” nuk ka të bëjë me zbatim selektiv të ligjit, derisa dikasteret tjera qeveritare do të jepnin shembullin e ekzistimit të shtetit ligjor, ku Zonat e Mbrojtura vërtet do të trajtoheshin si të tilla.

- *Institucionet t’i mbrojnë objektet me vlera të Prizrenit*

Institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin veprime për parandalimin e shkatërrimit të objekteve me vlera, sidomos në Qendrën Historike të Prizrenit. Komuna e Prizrenit, IMM-ja, MKRS-ja dhe organet tjera duhet të shtojnë përpjekjet në drejtim të identifikimit të objekteve me vlera dhe hapave konkretë për ruajtjen e tyre nga shkatërrimi i tërësishëm. Të zbatohet rekomandimi i KTK-së për shtëpinë e djegur të familjes Shehu. KTK të ndërmerr

nismën për diskutim të kësaj problematike me të gjithë hisedarët.

- *Të nis procesi për rishikimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*

Qeveria lokale dhe qendrore të angazhohen më me përkushtim për sigurimin e fondeve sistematike për restaurim dhe mirëmbajtje të Qendrës Historike, duke përfshirë të gjitha elementet përbërëse të saj dhe ta zhvillojnë atë si destinim turistik të mirëfilltë. Institucionet përgjegjëse të shqyrtojnë mundësinë për nisjen e procesit të rishikimit dhe ndryshimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, në mënyrë që mekanizmat e shumta që janë shtresuar mbi njëra-tjetrën të eliminohen dhe të përcaktohen masa më të rrepta ndëshkuese ndaj shkelësve individual dhe institucional.

- *Të rritet mbikëqyrja inspektuese në QHPz*

Organet komunale të zbatojnë në përpikëri dispozitat e Ligjit të Qendrës Historike të Prizrenit. Institucionet të shtojnë mbikëqyrjen inspektuese në këtë zonë, në mënyrë që praktikën e realizimit të projekteve pa lejet përkatëse të institucioneve përgjegjëse të mos përsëriten më, me qëllim që të ketë sundim të ligjit dhe mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore në qendër të Prizrenit.

- *PZHKP të shërbej si pikënisje për ndalimin e degradimit urbanistik në Prizren*

Autoritetet komunale të zbatojnë në përpikëri udhëzimet e ofruara të PZHKP-së për ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe vlerave të qytetit. Praktika e jetësuar me PZHUP-në nga Komuna e Prizrenit nuk bën të përsëritet me PZHKP-në, që përfundimisht duhet të shfrytëzohet si pikënisje për të iniciuar veprime konkrete për ndalimin e degradimit urbanistik, që tashmë ka marrë përmasa shqetësuese brenda Prizrenit.

- *Komuna dhe MMPH e MKRS ta lexojnë drejt Raportin e Progresit 2013 dhe të veprojnë menjëherë*

Gjuha e drejtpërdrejtë e Komisionit Evropian në raport me degradimin e trashëgimisë kulturore duhet të kuptohet si alarm dhe apel vendimtar për institucionet e Kosovës. Në raport me Qendrën Historike të Prizrenit, kjo porosi duhet të lexohet me shumë kujdes dhe të përkthehet në veprim të menjëhershëm nga autoritetet komunale të Prizrenit. Për më tepër, përgjegjësi direkte për të siguruar rend urbanistik në Prizren kanë edhe Ministria e Kulturës dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor. Institucionet shtetërore me veprime të menjëhershme duhet ta shpëtojnë trashëgiminë kulturore nga degradimi që vjen si pasojë e ndërtimeve pa leje.

- *Komuna të reflektoj mbi të gjeturat e Auditorit në lidhje me lejet ndërtimore dhe të zbatoj rekomandimet e ZAP-it*

Qeveria lokale në afatin më të shkurtër kohor duhet të shqyrtoj të gjeturat e Auditorit në lidhje me lejet ndërtimore dhe t'i ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimit të dhënë në këtë drejtim. Kryetari i Komunës duhet të urdhëroj DUPH-në dhe DI-në që bashkërisht të krijojnë një bazë të saktë të të dhënave për lejet ndërtimore, dhe në bazë të kësaj liste të nisin ekzekutimet në objektet pa leje dhe me tejkalime.

- *DUPH të ndërpres praktikën 'klandestine' të realizimit të projekteve*

DUPH-ja të respektoj ligjet dhe organet përkatëse, por edhe procesin e konsultimeve me shoqërinë civile në mënyrë që projektet që i zbaton të jenë në përputhje me ligjin dhe në dobi të qytetarëve. Kryetari i Komunës në

përputhje me kompetencat që ka duhet të marrë masa për ndërprerjen e praktikave të shkeljes së procedurave dhe ligjeve nga vet institucionet komunale, jo vetëm në Qendrën Historike por në tërë komunën e Prizrenit. Organet e drejtësisë të hetojnë këto raste dhe të sigurojnë sundimin e ligjit në sferën e urbanizimit.

- *DUPH, IMMH dhe MKRS të kenë një koordinim më të mirë gjatë shqyrtimit të kërkesave për lejet ndërtimore afër monumenteve historike*

Ligji për Trashëgiminë Kulturore të Kosovës të respektohet gjatë dhënies së lejeve ndërtimore në afërsi të monumenteve arkitekturale që janë nën mbrojtje. Trekëndëshi institucional, DUPH, IMMH dhe MKRS të kenë një koordinim më të mirë dhe të jenë më të kujdesshme me interpretimet ligjore dhe më aktive në terren gjatë shqyrtimit të kërkesave për lejet ndërtimore afër monumenteve të rëndësishme historike. Qeveria komunale të mos zbatoj standarde të dyfishta rreth shpronësimeve që lidhen me Trashëgiminë Kulturore dhe zhvillimin e saj.

VII. Aktivitetet/raportimi

Në periudhën raportuese të projektit janë ndërmarrë aktivitete të monitorimit duke përfshirë edhe avokimin, por dhe adresimin e shkeljeve ligjore të komunës së Prizrenit në sferën e urbanizimit. Monitorimi ka qenë i përqendruar në organet komunale, si Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizimit, Drejtoria e Inspektorateve dhe Këshilli për Trashëgimi Kulturore. Pastaj në mekanizmin rajonal që lidhet direkt me qeverisjen qendrore, Institutin për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës në

Prizren, derisa raportimet për shkeljet në Qendrën Historike gjatë kësaj faze i janë drejtuar Ministrisë së Kulturës. Në praktikën e vet të monitorimit EC Ma Ndryshe gjatë këtyre gjashtë muajve ka përfshirë edhe bashkëpunimin me Drejtorinë rajonale të Policisë së Kosovës në Prizren.

Monitorimi është performuar përmes stafit monitorues që ka pas qasje të papenguar në vendimmarrjen e këtyre institucioneve. Të gjeturat e monitorimit janë postuar në ueb-faqen, www.online-transparency.org, me një rubrikë të posaçme të Urbanism Watch.

Në kuadër të aktiviteteve është bërë publikimi i rregullt i të gjeturave të monitorimit përmes komunikatave të rregullta (dy-javore) për media, pastaj është prodhuar një analizë e shkurtë "Urbanizmi si lexim i qytetit" dhe shkrime e editoriale mujore në media të shkruara, ndërkohë që është krijuar edhe harta e shkeljeve urbanistike në qytetin e Prizrenit.

VIII. Ndikimi i projektit

Gjatë gjashtë muajve të zbatimit të projektit "Urbanism Watch..." janë arritur rezultatet si në vijim: 9 komunikata për shtyp që kanë trajtuar ekskluzivisht çështje që kanë të bëjnë me urbanizmin; 1 analizë mbi urbanizimin e qytetit; disa reagime publike mbi zhvillimet në urbanizëm dhe konferenca për shtyp. Këto aktivitete janë mbuluar nga mediet lokale dhe nacionale sipas të dhënave në vijim: 14 TV kronika me afër 35 minuta; mbi 30 artikuj në gazeta me rreth 11 faqe, afër 30 raportime në ueb portale dhe rreth 25 minuta raportim në radio. Gjatë këtyre muajve, projekti krahas sensibilizimit të opinionit vendor mbi zhvillimet në urbanizmin e Prizrenit, ka arritur që të tërheq edhe vëmendjen e përfaqësive

diplomatike, që kanë reaguuar publikisht në lidhje me shkatërrimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në Prizren, siç ka qenë rasti me reagimin e ambasadës britanike në Prishtinë dhe ambasadores amerikane në Prishtinë, lidhur me rastet e shtëpisë së familjes Shehu dhe objektit të ish-Jugobankës.

IX. Për projektin

“Urbanism Watch” synon të instalojë një sistem të monitorimit permanent të aktivitetit shtetëror (në dy nivelet e qeverisjes) në fushën e menaxhimit dhe zhvillimit urban në qytetin e Prizrenit, me theks të veçantë në Qendrën Historike të tij. Përmes të të gjeturave të monitorimit, ky sistem do të plotësohet me komponentët e publikimit dhe avokimit për të siguruar rend urbanistik në Prizren. Qëllimi themelor i projektit është të pengojë degradimin e mëtejshëm urbanistik të Prizrenit dhe të ndikojë në krijimin e mjedisit të përshtatshëm për zhvillim të kontrolluar dhe të qëndrueshëm urban, përmes rritjes së transparencës dhe sigurimit të llogaridhënies në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

Arritja e këtij qëllimi synohet përmes objektivave si: Rritja e nivelit të informimit publik mbi menaxhimin dhe zhvillimin urban të qytetit; Krijimi i mekanizmit permanent të monitorimit dhe publikimit të të gjeturave mbi urbanizmin dhe planifikimin hapësinor të qytetit; Krijimi i presionit qytetar ndaj institucioneve shtetërore për të kërkuar përgjegjësi dhe llogari në raport me rregullsinë urbanistike të qytetit; Parandalimi i ndërtimeve pa leje dhe atyre që shpërfillin kriteret e ndërtimit brenda Qendrës Historike të qytetit; Procedimi i lëndëve tek gjyqësori dhe qeveria qendrore për shkeljet e identifikuar gjatë

monitorimit. Projekti mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur.

X. Pse monitorimi i Urbanizmit të Prizrenit?

Periudha e pasluftës dhe tranzicioni në përgjithësi kanë sjellë me vete zhvillim të pakontrolluar edhe në Prizren, që është manifestuar me çintegrim urban, planifikim të pa-balancuar hapësinor, humbjen e tokës bujqësore e deri te degradimi i trashëgimisë natyrore në zonat rurale. Mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara të interesit, qoftë nga biznesi apo politika, në kurriz të ambientit jetësor të qytetarëve ka bërë që qyteti dhe zonat e mbrojtura natyrore të përfshihen nga një kaos urbanistik shkatërrimtar, pasojat e të cilit do të jenë afatgjate. Ndërtimet pa leje, përshtatja e Planeve Rregullative Urbane nevojave të grupeve të interesit që merren me biznesin e ndërtimtarisë dhe mos krijimi i mekanizmave të kontrollit bashkë me mos veprimin e duhur institucional, duke nisur nga Drejtoria e Urbanizmit, Inspektorati e deri te organet e drejtësisë kanë bërë që Prizreni të përjetoj një degradim të pariparueshëm urbanistik, duke rrezikuar madje edhe bërthamën qendrore të Zonës Historike.

Në kuadër të projektit të EC Ma Ndryshe mbi monitorimin e punës së ekzekutivit komunal të Prizrenit (nisur në mars 2012 dhe në vazhdim e sipër) është nxjerrë në pah faktin se mos respektimi i kriterëve të ndërtimit nuk ndëshkohet nga institucionet, ndërkohë që gjendja e krijuar në fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është alarmante pasi që ndërtimet vazhdojnë me shpërfillje të lejeve të ndërtimit të dhëna nga DUPH-ja. Gjatë këtij monitorimi është vërtetuar se rreth 80 për qind

e ndërtimeve në qytetin e Prizrenit nuk i përmbahen lejeve të ndërtimit, që bashkë me shprehjen e tendencës për pazarllëqe të ndryshme me kompanitë ndërtimore janë fenomeni dominues i projekteve urbanistike të financuara nga buxheti i komunës së Prizrenit. Me vite, EC Ma Ndryshe është duke theksuar se transparencja e komunës ka të meta strukturore dhe se përkundër përpjekjeve modeste të lidershit komunal vazhdon të jetë në nivel të ultë, që manifestohet me informim jo-adekuat, mos përfshirje të duhur në vendimmarrje dhe mungesë të llogaridhënies kundrejt qytetarëve.

Një nga pasojat direkte të këtij kaosi urbanistik në Prizren dhe qytetet tjera të Kosovës ka qenë edhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore, e cila nuk i ka shpëtuar viktimizimit nga sistemi i ri i “vlerave” pas lufte, që karakterizohet me mungesë totale të llogaridhënies e përgjegjësisë dhe me kulturë të mosndëshkimit. Në një mjedis të tillë, investitorët në ndërtimtari kanë arritur që paratë e fituara në rrugë joformale t’i shpërlajnë përmes ndërtimeve të shumta, gjatë të cilit proces ata i kanë korrupsuar edhe zyrtarët e pushteteve lokale të Kosovës. Esencialisht, problemi qëndron në mosndalimin dhe mosndëshkimin e veprimtarisë ekonomike joformale nga institucionet e shtetit. Rrjedhimisht, është pothuaj absurde të pritët që i njëjti shtet të vendosë rregull dhe të ndalojë aktivitete degraduese ndërtimore në qendrat historike të qyteteve. Sektori i ndërtimeve në Kosovë vazhdon të jetë njëri ndër më të përfolurit për keqpërdorime dhe korrupsion. Konkretisht, disa zyrtarë të komunës së Prizrenit dhe disa kompani ndërtimi janë nën hetime nga Prokuroria Themelore për parregullsi urbanistike. E njëjta gjendje vlen edhe për Prishtinën, ku disa nga zyrtarët komunalë janë të përfshirë në kaosin urbanistik që e ka kapluar kryeqytetin.

Menjëherë pas lufte dhe në vakuumin e përgjithshëm ligjor e institucional, qytetet e Kosovës u përfshinë nga një valë agresive ndërtimesh, që erdhën si reagim ndaj nevojave të mëdha të krijimit të hapësirave të reja të banimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit. Shkaku kryesor i këtij zhvillimi ishte migrimi i brendshëm rural – urban, i cili ka shtuar në mënyrë drastike numrin e popullsisë në qendrat urbane të Kosovës. Përveç mungesës së legjislacionit qendror për planifikim hapësinor, sistemi institucional i Kosovës ishte i papërgaditur edhe në nivelin komunal. Me struktura mjaft të brishta të qeverisjes dhe menaxhimit urban, komunat e Kosovës kishin shumë pak mundësi të kontrollojnë këtë urbanizim kaotik. Për më tepër, ishin vetëm zyrtarët komunalë, ata që u përfshinë në mënyrë direkte në shumë parregullsi urbanistike të kësaj periudhe, të cilat me intensitet të ndryshëm vazhdojnë të ndodhin edhe sot. Janë rreth dhjetë institucione qendrore dhe lokale që kanë përgjegjësi direkte për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe krijimin e rendit urbanistik të qyteteve. Përgjegjësia është e ndarë në formën që e implikon secilin institucion në masë të caktuar dhe që kërkon qasje të integruar në vendimmarrje dhe ekzekutim. Vala e ndërtimeve të egra dhe shfaqja e një sektori shumë të fuqishëm të ndërtimeve që nuk njihte ligje dhe rregullore arriti të amortizojë jo vetëm zyrtarët e qeverisë dhe të komunave, por edhe çdo mundësi të mobilizimit qytetar për mbrojtjen e qyteteve dhe të trashëgimisë së tyre kulturore. Trembëdhjetë vite pas përfundimit të luftës në Kosovë, numri i organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në këtë sektor është në mënyrë të papërfillshme i vogël. Në qytetet e Kosovës ende nuk kanë arritur mobilizimi i duhur i qytetarëve për të penguar degradimin e vazhdueshëm të shkaktuar nga grupe të

fuqishme interesi, të lidhura edhe me zyrtarë të lartë shtetëror në të dyja nivelet e qeverisjes.

Trekëndëshi themelor i urbanizmit brenda Qendrës Historike të Prizrenit përbëhet nga Drejtoria për Urbanizëm, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Drejtoria për Inspektorat. Derisa e para lëshon leje urbanistike, e dyta jep pëlqime për respektimin e parimeve të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Ndërsa Inspektoratit i mbetet që të monitorojë procesin e ndërtimit bazuar në këto dy dokumente. Ajo që ndodh realisht brenda komunës së Prizrenit është se zyrtarët e urbanizmit thonë që janë në rregull me dokumentet dhe lejet e lëshuara, ndërsa përgjegjësinë për tejkalime dhe ndërtime pa leje ia hedhin Inspektoratit. Këta të fundit thirren në buxhetin e pamjaftueshëm, numrin e vogël të inspektorëve dhe sidomos (ndonëse jo publikisht) në pamundësinë për t'ia ndalë punimet ndërtuesve, të cilët shpesh i përshkruajnë si "të fortë dhe të paprekshëm". Në gjithë këtë situatë, ai që i ka emëruar drejtorët e këtyre dikasterëve, kryetari i komunës së Prizrenit flet për kërkesat që ia ka drejtuar drejtorëve të tij për të vënë rregull urbanistik në qytet, duke e shpërfaqur pafuqinë e tij ekzekutive. As Kuvendi i Komunës nuk mund të amnistohet nga kjo përgjegjësi, pasi që ky institucion e ka miratuar "Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit", ndërsa asnjë herë nuk ka kërkuar përgjegjësi nga ekzekutivi i komunës për shkeljen me dy këmbë të këtij dokumenti.

Dimension tjetër i dështimit të shtetit është momenti kur në këtë pamje hyn gjyqësori. Drejtoria për Inspektorat ka ngjarë të ketë dërguar ndonjë kërkesë në Gjykatën për Kundërvajtje për të nisur proces gjyqësor ndaj ndërtuesve që i shpërfillin lejet e ndërtimit. Por

kjo nuk ka sjellë kurrfarë rezultati, duke ia rikonfirmuar fuqinë dhe paprekshmërinë ndërtuesve. Për më tepër, Prokuroria e Qarkut (tash Themelore) ka vite që zhvillon hetime në urbanizëm, ndërsa ende nuk ka arritur të shpallë aktakuzën, edhe pse dëshmitë janë shumë të dukshme dhe shumë shpesh të raportuara nga shoqëria civile dhe mediat. Në të njëjtën kohë, inspektorët e komunës gjatë punëve të inspektimit në terren, detyrohen të kërkojnë asistencë edhe nga Policia, e cila dërgon policë për të asistuar zyrtarët komunalë, por prezenca e tyre nuk i lehtëson aspak rrethanat e inspektimit.

Niveli qendror i përgjegjësisë institucionale për të mbrojtur qytetet është edhe më problematik. Janë disa ministri që kanë rol direkt dhe obligim ligjor për të parandaluar degradimin urbanistik dhe adresuar shkeljet. Ministrinë e kulturës, planifikimit hapësinor dhe pushtet lokal janë adresat kryesore në qeverinë qendrore, të mandatuara për të siguruar rend urbanistik në qytete. Ministria e Kulturës, përmes Departamentit të vet të Trashëgimisë Kulturore dhe Instituteve rajonale për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, duhet të veprojë si autoriteti më i lartë shtetëror për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në rastin e Prizrenit, kjo ministri nuk ka ndërmarr asnjë veprim konkret për të adresuar kaosin urbanistik që po ndodh në Qendrën Historike të qytetit nga viti 1999. Në anën tjetër, Ministria e Planifikimit Hapësinor vazhdon të mbetet e heshtur karshi shkeljeve të Planit Hapësinor të Kosovës dhe planeve lokale urbane në Prizren. E fundit në këtë linjë të përgjegjësisë, Ministria e Pushtetit Lokal reagon tepër rrallë dhe shumë herë me butësi të pabesueshme karshi mosrespektimit të ligjshmërisë në miratimin e akteve komunale në Prizren.

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “Emancipimi Civil Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – Ilogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”,: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).